



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 33

Prishtinë, më 16 janar 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N- 10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Mufera Şinik, Behar Selimi, Halit Krasniqi, Arsim Bajrami, Ardian Gjini, Amir Ahmeti, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, dhe Jasmina Zhivković.

Mungoi: Haki Demolli.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Sefadin Blakaj, SEAD / USAID, Artan Canhasi – EULEX, Vlora Marmullakaj – EULEX, Sanije Berisha - OSBE, Isuf Zejna – KDI, Selman Soboli – student (UP), Lumniye Murati- ZPRK, Eroll Gashi – student, Florije Mehmeti – KDI, Edon Myftari - këshilltar ligjor - NDI dhe ...

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 15 dhe 19.12. 2011,
3. Njoftimi i Komisionit me shkresën e datës 30.12.2011 të ndërmarrjes shërbyese “ Ekspertimi “,
4. Caktimi i datës për dëgjim publik për Projektligjin për marrëdhëniet e detyrimeve dhe Projektkodin penal të Kosovës,
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 15 dhe 19.12. 2011

Albulena Haxhiu- Kishte vërejtje në procesverbalin e datës 15.12.2011, tek votimi i Projektregullores, sepse unë kam abstenuar kur është votuar kjo pikë.

Armend Zemaj - Kishte vërejtje në procesverbalin e datës 15.12.2011 dhe tha: “ Tek rekomandimi kur është votuar Projektregullorja, dy pasuesit e fundit nuk e kanë vendin këtu” .

Kryetari - Konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 15 dhe 19.12.2011, me vërejtje.

3. Njoftimi i Komisionit me shkresën e datës 30.12.2011 të ndërmarrjes shërbyese “ Ekspertimi “

Kryetari- I njoftoi me shkresën e datës 30.12.2011 të ndërmarrjes shërbyese “ Ekspertimi “ dhe vlerësoi se kjo çështje nuk bie në fushëveprim të Komisionit, andaj vetëm është vendosur në rend dite për njoftimin tuaj.

4. Caktimi i datës për dëgjim publik për Projektligjin për marrëdhëniet e detyrimeve dhe Projektkodin penal të Kosovës

Kryetari - Tha se është koha të mbajmë dy dëgjime publike për Projektligjin për marrëdhëniet e detyrimeve dhe Projektkodin penal të Kosovës. Propozoi që me datën 25.01.2012 të mbajmë dëgjim publik për Projektligjin për marrëdhëniet e detyrimeve, kurse më 8.02.2012, për Projektkodin penal të Kosovës.

Armend Zemaj - Duke folur për Projektkodin penal të Kosovës tha se duhet të fillojë punën grupi i punës dhe nuk do të thotë të presim deri pas dëgjimit, sepse duhet të orientohet puna dhe duhet të caktohen ekspertët. E njëjta metodë mund të vlejë edhe për Projektligjin për marrëdhëniet e detyrimeve.

Arsim Bajrami - U pajtua që dëgjimet publike të mbahen në datat e propozuara, sepse janë dy ligje organike, por duhet të shikojmë çështjen e afateve, sepse këto dy projektligje janë miratuar në parim para festave të fundvitit. Ai vlerësoi se gjatë procesit të shqyrtimit të këtyre projektligjeve, detyrimsht duhet t'i përfshijmë ata që kanë punuar në këto projektligje, në mënyrë që me amendamente mos ta dëmtojmë konceptin e tyre.

Albulena Haxhiu- Kishte vërejtje në atë se, përkundër asaj që grupet e punës janë formuar në vitin e kaluar, ende nuk janë thirrur në asnjë takim. Ajo tha se është e rëndësishme që të kemi takim me ministrin e Ministrisë së Drejtësisë. Në vazhdim, ngriti çështjen se ky është një Projektkod që e kanë punuar ekspertët vendorë dhe ministri Drejtësisë: “ më ka thënë se nuk ka kod që e kanë punuar ekspertët vendorë, është ky kod që i është proceduar Kuvendit”, e që sipas saj, kjo nuk është e vërtetë, sepse unë jam takuar me shumë anëtarë që kanë punuar në atë draft dhe nuk e kanë marrë parasysh. Nuk po them që është më i mirë ky version apo ai, por ministri duhet të tregojë arsyet pse nuk është marrë parasysh drafti i punuar nga ekspertët vendorë.

Behar Selimi - Si kryesues i grupit të punës dha sqarime pse nuk është thirrur grupi i punës deri më tash, ai njoftoi se takimin e parë do ta thërrasë gjatë javës së ardhshme dhe do të fillohet të punohet në këtë draft që e kemi.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion lidhur me këtë pikë njëzëri nxori këtë

Përfundim

Komisioni vendosi që të mbajë dëgjim publik për Projektligjin për marrëdhëniet e detyrimeve me datën 25.01.2012, kurse për Projektkodin penal me datën 08. 02. 2012.

5. Të ndryshme

a. Shqyrtimi i kërkesës së Shadije Gergurit

Komisioni e shqyrtoi kërkesën e Shadije Gergurit dhe vendosi që ta njoftojë Grupin Parlamentar 6 + lidhur me propozimin e kandidatit për anëtar të Këshillit Gjyqësor nga Grupi Parlamentar 6+. Komisioni, duke u bazuar në shkresën e datës 18.11.2011, me të cilën është propozuar Raime Rama-Elezi, anëtare e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe në pajtim me propozimin e GP 6+, Komisioni i ka rekomanduar Kuvendit që Raime Rama - Elezi të emërohet anëtare e Këshillit Gjyqësor.

b. Shqyrtimi i shkresës së QKUK-së

Komisioni e shqyrtoi kërkesën e Komisionit i themeluar nga Këshilli i Fakultetit të Mjekësisë për shqyrtimin e statutit të QKUK-së, që ka të bëjë me mënyrën e aprovimit të këtij statuti. Komisioni vlerësoi se kjo çështje nuk bie në fushëveprimin e Komisionit dhe i procedohet Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Albulena Haxhiu - Ju e dini që sot në orën 12:00, 25 organizata joqeveritare protestojnë para Qeverisë kundër dhunës policore të ushtruar ndaj protestuesve paqësorë, andaj si anëtare e Komisionit ndiej obligim që t'ju bëj ftesë t'i bashkëngjiteni protestës kundër dhunës policore.

Ardian Gjini - I njoftoi anëtarët se shumë shpejt do të jetë në lexim të parë Projektregullorja e punës së Kuvendit dhe kërkoi që të gjithë anëtarët e Komisionit, sidomos ata që kanë marrë pjesë në grupin e punës, duhet të punojnë me grupet parlamentare të tyre, sepse rrezikojmë që Projektregullorja mos të kalojë në lexim të parë pas gjithë asaj pune që është bërë.

Armend Zemaj - Duke folur rreth protestës së organizuar nga VV-ja, tha se integriteti i deputetit është cenuar, pa marrë parasysh rrethanat që janë zhvilluar. Prandaj, unë propozoj që si Komision, si dhe duke pasur parasysh vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës rreth mandatit, imunitetit dhe privilegjet e deputetit, propozoj që të futet në agjendë rihartimi i ligjit, sepse ky ligj më nuk është funksional, pasi që shumë nene të tij janë shfuqizuar dhe si i tillë është i pazbatueshëm.

Arsim Bajrami -Duke u ndërlidhur me parafolësin tha se, duke pasur parasysh vendimet e Gjykatës Kushtetuese për imunitetin e deputetit dhe vendimin për pensionin suplementar, kanë ndikuar në ligj dhe e përkrahu idenë që të merret iniciativa për rishkrimin e ligjit.

Kryetari - U pajtua me parafolësit se duhet të merret parasysh nisma për rishkrimin e ligjit për deputetët, ndërsa duke folur rreth protestës së organizuar nga VV-ja, tha se ka qenë situatë shumë e rëndë, e cila realisht ka rrezikuar perceptimin e qytetarëve për shtetin. Ai tha se rruga nuk është zgjidhja e problemeve, sepse kemi institucionet dhe ato duhet ta bëjnë zgjidhjen e problemeve. Mirëpo kur shteti reagon dhunshëm dhe dhuna ushtrohet ndaj qytetarëve dhe përfaqësuesve të qytetarëve, kjo shkon drejt diktaturës dhe diktatura është e palejshme.

Ardian Gjini - Duke u ndërlidhur me diskutimet e parafolëseve tha se detyrimisht kemi ardhur deri tek nevoja e rishikimit të legjislacionit që rregullon imunitetin e deputetit. Nuk është e tepërt të them se nuk kam besuar që kanë për t'i rrahur deputetët e Kosovës, nuk ka qenë dashur të ndodhë. Kam menduar se do të pritet pak kohë, në mënyrë që mos të ketë reagim të shpejtë, për shkak se po më duket që po bëhen reagime zinxhirore, që nuk kemi nevojë të lejojmë të ndodhë diçka e tillë. Po më duket se ka ardhur koha që deputetët e Kosovës të ndjehen si gardianë të sistemit, sepse po rrezikohet sistemi, dhe nuk po etiketoj se kush po e rrezikon sistemin. Meqenëse kjo temë u hap, e mbështes idenë që të fillojë rishkrimi i legjislacionit, jo vetëm një ligj, për shkak se është jashtëzakonisht e pahijshme të goditet deputeti.

Albulena Haxhiu - Tha se protesta e VV-së ka qenë plotësisht paqësore, e cila ka pasur për qëllim mbrojtjen e vendimit të Republikës së Kosovës për reciprocitet ekonomik, politik dhe tregtar. Protesta është shtypur në mënyrë të dhunshme nga Njësia speciale me urdhër të Qeverisë së Kosovës. Pjesëmarrja e Lëvizjes Vetëvendosje në institucionet e Kosovës, është vetëm një mjet shtesë për realizimin e qëllimeve tona, andaj protestat dhe aksionet e caktuara janë të domosdoshme, sidomos kur ka një pushtet të tillë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi